

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “ PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7651, DATË 21.12.1992, “PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE”, TË NDRYSHUAR”

QELLJMI I PROJEKTAKTIT

Projektligji ka si synim një ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar. Ndryshimi në projektligj synon vendosjen si festë zyrtare datën 21 shtator , si dita e çeljes së punimeve të kongresit të Lushnjës në 21 janar të vitit 1920.

ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT

Nisur nga fakti historik se Kongresi i Lushnjës është ngjarja e dytë më e madhe historike prej vitit 1912 pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të vitit 1912, dhe meqënëse jemi në prag të 100 vjetorit të mbajtjes së kongresit të Lushnjës i cili shënon dhe 100 vjetorin e Parlamentarizmit Shqiptar është mëse e drejtë që kjo datë të shpallet si festë kombëtare dhe si datë historike e historise se Shqiperise Po ashtu Këshilli Bashkiak i Bashkisë Lushnjë në mënyrë unanime ka votuar një vendim që ja përcjell Kuvendit të Shqipërisë ku i kërkon që data 21 janar të shpallet festë kombëtare.

Kongresit I Lushnjës është akti themelor kushtetues për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Kongresi u mbajt prej 21-deri më 31 janar të vitit 1920, në shtëpinë e patriotit lushnjar Kaso Fuga. Në të u miratua një akt kushtetues për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Gjatë ditëve të punimeve Kongresi zgjodhi këshillin e lartë prej 4 vetash, që do të kryente funksionet e kryetarit të shtetit dhe një këshill kombëtar me 37 veta. Kryeministër u zgjodh Sulejman Delvina. Kryeqytet u shpall Tirana. Sipas dokumenteve të kohës nga viti 1922 deri me 1939, kongresi i Lushnjës ka qenë festë zyrtare. Por pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste dhe më vonë nga nazistët gjermanë, si dhe gjatë periudhës së regjimit komuniste, ngjarja gati u la në harresë.

Kongresi i Lushnjës, është një ngjarje e rëndësishme jo vetëm për qytetin e Lushnjës, por për gjithë Shqipërinë, ndaj kërkojnë edhe mbështetjen e gjithë shqiparëve kudo ku ata janë.